



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.18

2001

Prill

### P Ë R M B A J T J A

Ligji nr.8761,  
datë 2.4.2001

Për miratimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës  
“BOT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe  
Privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës turke “BER –  
ONER” për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të  
kromit, si dhe për dhënien e disa stimujve dhe garancive  
për koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje”..... 537

Ndreqje gabimesh 558

**L I G J**  
**Nr.8761, datë 2.4.2001**

**PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” NDËRMJET  
MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË SË TË  
DREJTËS TURKE “BER-ONER” PËR DISA OBJEKTE TË INDUSTRISË SË BAKRIT DHE TË  
KROMIT, SI DHE PËR DHËNIEN E DISA STIMUJVE DHE GARANCIVE PËR  
KONCESIONARIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja e koncesionit të formës “BOT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës turke “Ber-Oner Madencilik San.Ve.Tic.A.S.” për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit”.

Lista e objekteve të industrisë së bakrit dhe të kromit, që jepen në koncesion, është përfshirë në këtë Marrëveshje që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Shoqëria koncesionare (tregtare), e themeluar prej palës koncesionare, përjashtohet:

a) nga detyrimet për pagimin e taksave doganore dhe të TVSH-së për makineritë, linjat dhe pajisjet që do të përdoren për investime për një afat 5-vjeçar;

b) nga detyrimi për pagimin e tatim-fitimit për pesë vite të plota ushtrimore, pas vitit të tretë;

c) nga detyrimi për pagimin e taksës doganore dhe të TVSH-së për makineritë, pajisjet dhe lëndën djegëse, që do të përdorë për prodhimin e energjisë elektrike, të nevojshme për objektet e koncesionit, pas 5 viteve të para, në rast se koncesionari do të kërkojë ta prodhojë vetë këtë energji elektrike.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të koncesionit, Këshilli i Ministrave të trajtojë detyrimet ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve që ka shoqëria tregtare “Albbakër” sh.a., Tiranë për objektet që jepen në koncesion.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të koncesionit, punonjësit që do të shkurtohen si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes, të trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Ligji nr.8565, datë 22.12.1999 “Për miratimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” në industrinë e bakrit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë së të Drejtës së Shtetit Utah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “The Metal Research Group Corp”, si dhe dhënies së disa stimujve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje” shfuqizohet.

## Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2964, datë 9.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

### MARRËVESHJE KONCESIONI

E lidhur midis:

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, më poshtë e quajtur OSHA, e përfaqësuar nga zoti Pajtim Bello, me detyrë Zëvendësministër, Ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i pajisur me autorizimin Nr. 689, datë 18.1.2001, të Ministrit të kësaj Ministrie.

dhe

Kompanisë aksionere sipas së drejtës turke të emërtuar: “BER-ONER Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş.” me seli në Büyükdere Cad. Noramin İş Merkezi. No: 55 K: 3 D : 304 MASLAK-ISTANBUL, Turkey, e regjistruar me Nr.237240 – 184807, datë January 13, 1993, më poshtë referuar si “ koncesionari” i përfaqësuar për qëllimin e negociimeve dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Koncesioni, nga inxhinier. Hasan Berkpinar, me detyrë president i Kompanisë dhe ing. Ayhan Cetiner, me detyrë koordinator, në bazë të prokurës së lëshuar me 15.1.2001 nga inxhinier. Hasan Berkpinar në cilësinë e presidentit të Kompanisë “BER-ONER Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş.” dhe Erol Kohen si anëtar i bordit, që i bashkëngjitet kësaj Marreveshjeje Koncesioni.

Meqenëse egzistojne këto kushte paraprake:

Në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë së vendit, qeveria shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit të industrisë minerare.

Koncesionari është i interesuar të investojë në industrinë minerare për rehabilitimin dhe vënien në funksionim të industrisë së bakrit dhe dy minierave të kromit në zonën e Hasit, sipas kushteve e afateve të paraqitura në studim (projekt) dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë “Projekti”).

Palët kanë rënë dakort dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë me njëra tjetrën, për realizimin e plotë të Projektit.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” (ndryshuar me akte të tjera ligjore) ka shqyrtuar dhe miratuar propozimin (studimin dhe/ose Projektin) e paraqitur nga Kompania “BER-ONER Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş.” dhe me vendimin nr.602, datë 17.11.2000, i ka dhënë Kompanisë “BER-ONER Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş.”, të drejtën për të marrë në koncesion të formës “BOT” objektet e përcaktuara në Aneksin 1.

Këshilli i Ministrave i ka besuar Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit negociimin dhe nënshkrimin e kësaj Marreveshjeje koncesioni.

Palët kanë rënë dakort sa më poshtë:

## Neni 1

### Përkufizime

Për zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrveshjeje koncesioni, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Marrëveshje koncesioni: Ky dokument dhe anekset e tij;  
Koncesionare: Kompania aksionere e së drejtës turke, e emërtuar “BER-ONER

Kontratat:	Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş.” me seli në, Büyükdere Cad. Noramin İş Merkezi. No: 55 K: 3 D : 304 MASLAK-ISTANBUL, Turkey, e përfaqësuar për qëllimin e negocimeve dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje koncesioni nga inxhinier. Hasan BERKPINAR dhe ing. Ayhan CETINER, me detyrë koordinator në bazë të prokurës së lëshuar më 15.1.2001 nga inxhinier. Hasan BERKPINAR dhe Erol KOHEN në emër të kompanisë “BER-ONER Madencilik Sanayi. ve Ticaret A.Ş”.
Sipërmarrës:	Të gjitha kontratat e përfunduara për të siguruar shërbimet, pajisjet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit;
Ndryshimi i ligjit:	Të gjithë nënkontraktorët dhe furnizuesit për zbatimin, ndërtimin, furnizimin e bazës materiale dhe të pajisjeve teknologjike të nevojshme për Projektin;
Objekti i Marrëveshjes BOT:	Do të thotë çdo akt ligjor i miratuar nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje koncesioni;
Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA):	Objektet e industrisë së bakrit dhe të kromit të specifikuara ne Aneksin 1;
Palët:	Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë (ose Ministria që do të mbulojë aktivitetin minerar);
Lejet:	Janë OSHA dhe Koncesionari;
Periudha e koncesionit:	Lejet, licencat dhe autorizimet që mund të kërkohen për zbatimin e plotë të Projektit;
Projekt:	Është 30 vjet që nga momenti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së koncesionit;
Shoqëria Koncesionare:	Projekti (studimi) i paraqitur për marrjen e koncesionit dhe i përmbledhur në Aneksin 2, që ka për objekt rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e objektit të Marrëveshjes së Koncesionit;
Asete:	Shoqëria tregtare e krijuar nga Koncesionari, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
	Inventari i objekteve prodhuese, ndihmëse e administrative, të përfshira në koncesion, dhe që gjendet në filialet e Allbakrit e të Albbkromit, (përfshirë dhe objektet ndihmëse e administrative në Tiranë për Albbakrin), me gjendjen aktuale në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

## Neni 2

### Objekti i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka për objekt dhënien në koncesion të objekteve të përcaktuara në Aneksin 1, që OSHA (Organi Shtetëror i Autorizuar nga Këshilli i Ministrave), ia beson Koncesionarit, për të realizuar rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e këtij Objekti;

## Neni 3

### Kriteret specifike të punimeve

Kriteret specifike të punimeve do të jenë si më poshtë:

Në objektet e koncesionit do të investohen gjate tre fazave të ndërvarura nga njëra tjetra (e dyta nga e para dhe e treta nga e dyta), gjithsej 19 811 500 USD;

Në fazën e parë do të investohen 3 735 000 USD për:

rikonstruksionin e punimeve ekzistuese dhe hapjen e punimeve të tjera minerare në minierën e Vlahnes, me vleftë 100 000 USD;

rikonstruksionin e punimeve ekzistuese dhe hapjen e punimeve të tjera minerare në minierën e Perollajt, me vleftë 30 000 USD;

investime për minierën e Vlahnes dhe të Perollajt, me vleftë	180 000 USD;
ndërtim montime për minierën Vlahen e Perollaj, me vleftë	60 000 USD;
studime e projektme për Vlahen dhe Perollaj, me vleftë	50 000 USD;
Gjithsej faza e parë investime në krom	420 000 USD.
rehabilitimin e minierës së Lak-Roshit, me vleftë	200 000 Usd;
hapjen e pjesshme të vendburimit të Munellës (traverbangjeve +675 m dhe +725 m) dhe kryerjen e punimeve të shpimeve nëntokësore për verifikimin e rezervave të dhëna nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, do të investohen 795 000 USD;	
investime për minierën e Lak Roshit, në vlerën	190 000 USD;
investime për minierën e Munellës, në vlerën	1 300 000 USD;
Për kërkime të reja gjeologjike, në vlerën	100 000 USD;
studime në vlerën	100 000 USD;
investime të ndryshme, kryesisht për bakrin, në vlerën	630 000 USD;
Gjithsej faza e parë e investimeve në baker	3 315 000 USD.

Këto investime do të kryhen sipas Projektit të paraqitur në Aneksin 2.

Në rast se pas kryerjes së këtyre investimeve, që kanë për qëllim verifikimin e rezervave gjeologjike në krom e në bakër, si dhe marrjen e rezultateve ekonomikisht të pranueshme nga studimet teknologjike të përpunimit të këtyre mineraleve, do të vazhdojnë investimet e fazës së dytë.

Në rast rezultatesh negative, veçanërisht në vërtetimin e rezervave gjeologjike në sasi e në cilësi, Koncesionari do të tërhiqet në mënyrë të njëanëshme nga sektori i kromit apo sektori i bakrit apo nga e gjithë kjo Marveshje koncesioni.

Në fazën e dytë do të investohen	11 926 500 USD
Kryerjen e të gjitha punimeve të paraqitura në Aneksin 2, si më poshtë:	
Për minierën Vlahen	575 000 USD;
Për minierën Perollaj	225 000 USD;
Për Fabrikën e pasurimit të mineraleve të kromit	1 810 000 USD;
Për studime e projektme	20 000 USD;
Shuma për kromin	2 630 000 USD.
Për minierën Munellë	2 305 000 USD;
Për minierën Lak - Roshi	970 000 USD;
Për fabrikën Fushë Arrëz	3 265 000 USD;
Për kërkime gjeologjike	400 000 USD;
Për studime e projektme	500 000 USD;
Për investime të ndryshme dhe të paparashikuara	1 856 500 USD;
Shuma për bakrin	9 296 500 USD.

Në fazën e tretë do të investohen 4 150 000 USD për:

ndërtimin e linjës së briketimit të koncentrateve të bakrit në Rubik, me vlerë 2 400 000 USD;  
përmirësimin e kushteve të punës në Metalurgjinë e Rubikut e në Fabrikën e rafinimit të bakrit, me vlerë 500 000 USD;  
rikonstruksione të ndryshme në Fabrikën e rafinimit të bakrit në Rubik, me vlerë 300 000 USD;  
hapjen e pusit kryesor në Vllahen 650 000 USD;  
fondin rezervë dhe fondin për investimet të ndryshme, me vlerë 300 000 USD;

Këto investime do të bëhen sipas Projektit të paraqitur në Aneksin 2, vetëm atëherë kur për kromin do të vërtetohen rezervat e dhëna nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me kushtet e sotme të pasqyruara në Projekt, për thellësinë e vendburimit Vlahen; ndërsa për Uzinën e Rubikut, si pasoje e zhvillimit të punimeve minerare në Munellë dhe në Lak -Rosh, të jetë verifikuar sasia dhe cilësia e mjaftueshme e rezervave gjeologjike, të cilat do të mbështesin programin e prodhimit, investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve të paraqitur në Aneksin 3.

Kryerja e investimit në Uzinën e Rubikut (Metalurgjia dhe Fabrika e rafinimit) dhe në impiantin e fraksionimit të skorjeve të bakrit në Shëngjin, është e kushtëzuar edhe me detyrimet për zhdëmtimin e dëmeve që mund t'i shkaktohen ambjentit nga hedhja në atmosferë e gazeve të shkrirjes së mineraleve

dhe koncentrateve të bakrit, si dhe përpunimit të bakrit blistër e nënprodukteve të tij. Vendimi për fillimin e investimeve do të merret nga koncesionari dhe OSHA-ja, pas vënies në punë të Uzinës, me teknologjinë ekzistuese, matjes së parametrave të ndikimit të ndotjes së ambjentit, si dhe nxjerrjes së efektivitetit ekonomik.

Për një periudhë 18-mujore, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të objekteve të tjera të koncesionit, Uzina e bakrit Rubik (Metalurgjia dhe Fabrika e rafinimit) dhe impianti i fraksionimit të skorjeve të bakrit në Shëngjin, do të jenë objekt i kësaj Marrëveshjeje koncesioni dhe do të mbahen në konservim.

Administrimi dhe shpenzimet e konservimit do të jenë të përbashkëta, OSHA-ja dhe Koncesionari, 50 % me 50 %.

Në fazën e dorëzimit të objekteve të tjera të koncesionit, për sa i përket Uzinës së bakrit Rubik (Metalurgjia dhe Fabrika e rafinimit) dhe impiantit të fraksionimit të skorjeve të bakrit në Shëngjin, do të hartohet Marrëveshja e Përbashkët midis Palëve, për realizimin e konservimit.

Në këtë fazë mund të investohen edhe 4 821 000 USD për:

hapjen dhe vënien në shfrytëzim të minierës së Karmës dhe rikonstruktimit të Fabrikës së Mjedës, me vlerë 4 571 000 USD;

fondin rezervë dhe të investime të ndryshme, me vlerë 250 000 USD;

Ky investim do të vendoset të bëhet në Marrëveshje ndërmjet OSHA-së dhe Koncesionarit dhe vetëm atëherë kur do të zbulohen rezerva të reja në Karmë, të cilat për nga sasia dhe cilësia do të justifikojnë këtë investim.

Për rastin më të mirë, investimet në fazën e tretë do të jenë 8 971 000 USD, dhe, në total, për të tre fazat së bashku, 24 632 500 USD.

#### Neni 4

##### **Koha e fillimit të punimeve**

Koncesionari do të fillojë punimet, sipas specifikimeve të përcaktuara në nenin 3, brenda 60 ditëve pas datës së marrjes në dorëzim nga OSHA-ja të dokumentacioneve teknike dhe ekonomiko-financiare të Objekteve të Koncesionit, si dhe të datës së marrjes në dorëzim të këtyre objekteve.

Koncesionari do të paraqitet për marrjen në dorëzim të dokumentacionit teknik dhe ekonomiko-financiar të objekteve, si dhe të vetë objekteve, brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate koncesioni.

Dorëzimi i dokumentacionit duhet të përfundojë brenda 20 ditëve dhe, vetëm pas marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni (veçanërisht atij gjeologjik me gjendje punimesh deri 31.12.2000), do të fillojë procedura e marrjes në dorëzim nga Koncesionari i objekteve të dhëna në koncesion.

#### Neni 5

##### **Detyrimet e Koncesionarit**

- 5.1 Koncesionari brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje do të formojë shoqëri koncesionare dhe do të bëjë regjistrimet e nevojshme për të lejuar shoqërinë të zhvillojë veprimtari në Shqipëri dhe do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
- 5.2 Koncesionari merr përsipër të kryejë gjithçka që nevojitet për realizimin e objektit të Marrëveshjes që i është besuar në koncesion, në kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- 5.3 Të respektojë të drejtën e OSHA-së për ruajtjen e pronësisë të mjeteve kryesore, të dhëna në koncesion, për sa kohë që ato nuk do të transformohen nga koncesionari.
- 5.4 Të respektojë të drejtën e ndërhyrjes së OSHA-së, deri në marrjen në dorë të Projektit përkohësisht, në rastet kur konstatohen shkelje të rënda (me përjashtim të forcës madhore dhe

rasteve kur OSHA-ja dhe Koncesionari bien dakort midis tyre), si:

- a. braktisje punimesh;
- b. tërheqje arbitrare dhe pa shkaqet e ligjëruara në këtë Marrëveshje.

#### 5.5 Në mënyrë të veçantë Koncesionari merr përsipër:

të realizojë Projektin me mjetet e veta finaciare, sipas specifikimeve të nenit 3;  
të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për Projektin që do të zbatohet, të cilat do t'i marrë nga OSHA-ja;  
të marrë masa me qëllim që çdo punim i besuar në sipërmarrje të realizohet në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Projektin;  
të ruajë dhe të administrojë Objektivin e Marrëveshjes gjatë gjithë periudhës së koncesionit, në përputhje me specifikimet e kësaj Marrëveshjeje;  
të respektojë dhe të kërkojë që të respektohen të gjitha dispozitat ligjore në fushën e marrëdhënieve të punës;  
të shmangë dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e karakterit të përgjithshëm teknik, për të parandaluar çdo dëm dhe fatkeqësi në punë;  
për pasurinë e dhënë në koncesion, të lidhë kontrata sigurimi konform legjislacionit në fuqi;  
Koncesionari detyrohet që, me përfundimin e Periudhës së Koncesionit, t'i transferojë OSHA-së të rehabilituar Objektet e marra në koncesion.

5.6 Brenda 30 ditëve pas miratimit të Marrëveshjes së Koncesionit nga Këshilli i Ministrave, Koncesionari do të japë një garanci bankare për OSHA-në në shumën prej 300 000 USD nga Banka Turke nëpërmjet Bankës në Shqipëri. Shuma e garancisë bankare do të pakësohet automatikisht në proporcion me sasinë e investimit të realizuar.

i) Në rast se Koncesionari tërhiqet nga Marrëveshja, shuma prej 300 000 USD, e ngurtësuar si garanci për OSHA-në, kalon për llogari të OSHA-së. Në rast se kjo Marrëveshje koncesioni nuk ratifikohet nga Kuvendi Shqiptar, kjo garanci zhblokohet menjëherë.

### Neni 6

#### Të drejtat e koncesionarit

Nuk përgjigjet për detyrimet që mund të kenë kompanitë shtetërore "Albbakër" dhe "Albkrom" ndaj Shtetit dhe të tretëve gjatë ushtrimit të aktivitetit të mëparshëm të tyre në objektet që përfshihen në këtë Marrëveshje koncesioni, si dhe për pretendimet e të tretëve për pronësi mbi tokën apo mbi objektet e marra në koncesion.

Ka të drejtë ekskluzive të kryejë aktivitet ekonomik në objektet që i janë dhënë në koncesion.

Në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr. 7973, datë 26.07.1995, ka të drejtë të:

eksportojë të gjitha llojet e mineraleve që prodhon dhe që janë të tregtueshëm, si dhe të gjitha produktet e nënproduktet e përpunimit të këtyre mineraleve, pa kufizuar shkallën e përpunimit të tyre, përfshi këtu edhe të drejtën e eksportimit të metaleve të çmuara.

importojë pa kufizim pajisje, makineri dhe materiale të ndryshme që do të nevojiten për procesin e prodhimit, duke përfshirë edhe lëndët eksplozive, konform legjislacionit në fuqi.

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja", ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kontributet financiare të tij.

Në çdo kohë, që objekte të veçantë të objektit të koncesionit që ka marrë në dorëzim, të cilët do të rezultojnë pa efektivitet ekonomik, t'ia rikthejë OSHA-së, mbi bazën e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ekonomik.

Koncesionari ka të drejtë të përcaktojë numrin e punonjësve dhe të bëjë përzgjedhjen e tyre për realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Për rastet e forcës madhore, përfiton të drejtën që i jep neni 6 dhe neni 9 pika 2 e ligjit nr. 7764, datë 02.11.1993, "Për investimet e huaja".

## Neni 7

### Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

Të verë në dispozicion të Koncesionarit asetet (inventarin sipas përcaktimit në nenin 1) e Objektivit të Koncesionit, të përcaktuara në nenin 2 dhe Aneksin 1, në gjendjen në të cilën ndodhen ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

T'i dorëzojë Koncesionarit, brenda 45 ditëve pas dorëzimit të dokumentacionit teknik dhe atij ekonomik-financiar, asetet e objektivit të koncesionit, sipas kërkesave dhe nevojave të tij, duke hartuar në fund të këtij procesi dorëzimi, procesverbalet përkatëse, të cilat do të firmosen nga të dy palët.

Të ndihmojë dhe të japë asistencën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të objekteve të koncesionit nga Koncesionari në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Të ndihmojë dhe të asistojë Koncesionarin në nxjerrjen e të gjitha autorizimeve të nevojshme, lejet e punës dhe leje qëndrimi për specialistët e huaj, lejet e punimeve, lejet e ndërtimeve dhe ato të mbrojtjes së mjedisit etj., sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari, me kusht që kërkesat e bëra të jenë të përpiluara në formën që kërkon ligji.

Të ndihmojë dhe të asistojë Koncesionarin për realizimin e Projektit të tij pranë çdo organi, autoriteti shqiptar e t'i garantojë Koncesionarit dhe/ose Shoqërisë Koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e Projektit, për objektet e dhëna në koncesion gjatë periudhës së koncesionit.

Të ruajë nivelin e çmimit aktual të energjisë elektrike prej 4,5 lekë për kwh, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.564 datë 23.10.2000, për industrinë e bakrit dhe kromit për një periudhë 5 vjeçare. Pas 5 vjetëve, për energjinë që mund të dojë të prodhojë vetë Koncesionari, të përjashtohet nga taksat doganore dhe TVSH-ja, për makineritë, pajisjet dhe lëndën djegëse që do të duhen për prodhimin e kësaj energjie elektrike; si dhe të ndihmojë Koncesionarin për marrjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

Të garantojë Koncesionarin për 5 vjet për një furnizim normal dhe pa ndërprerje me energji elektrike, duke i krijuar të gjitha kushtet lehtësuese për sigurimin e sasisë së energjisë elektrike të nevojshme për realizimin e Projektit dhe prodhimeve të planifikuara në këtë Marrëveshje koncesioni.

Të mbledhë dhe t'i dorëzojë Koncesionarit, brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjithë dokumentacionin teknik dhe ekonomik-financiar, për objektet që do të jepen në koncesion dhe veçanërisht dokumentacionin gjeologjik me gjendjen e punimeve të kryera deri më 31.12.2000.

Të krijojë kushte për fillimin e punës në Uzinën e bakrit Rubik, për shkrirjen e mineraleve dhe koncentrateve të bakrit, si dhe për përpunimin e bakrit blister e nënprodukteve të tij, për një periudhë disa mujore për Koncesionarin, si dhe duke u angazhuar me të për nxjerrjen e treguesve që ndikojnë në ndotjen e ambientit dhe në marrjen e vendimit për fillimin e investimit.

Të sigurojë Koncesionarin edhe me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit Shtet në industrinë minerare, se legjislacioni në përputhje me të cilin është lidhur kjo Marrëveshjeje do të zbatohet gjatë gjithë periudhës së koncesionit. Ndryshimet në këtë legjislacion, përfshirë këtu edhe hyrjen në fuqi të ligjeve të reja, nuk do të jenë të zbatueshme, me përjashtim të rastit kur këto ndryshime ligjesh ose ligje të reja që hyjnë në fuqi, favorizojnë Koncesionarin.

Të bëjë propozimet përkatëse dhe mbrojtjen e nevojshme, në organet kompetente shqiptare, për të realizuar mbështetjen për Projektin sipas nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi që lidhet me pretendimet e personave të ndryshëm për pronësi mbi tokën dhe objektet e dhëna në koncesion, si dhe pretendimet e të tretëve për borxhet që mund të kenë objektet e kësaj Marrëveshjeje gjatë ushtrimit të aktiviteve të mëparshme.

Konform legjislacionit në fuqi, të lirojë objektet, veçanërisht ato ndihmëse, si magazina, ofiçina, laboratore, menca, fjetore etj., të objektivit të koncesionit, të cilat janë zënë arbitrarisht nga persona privatë.

Të marrë përsipër zgjidhjen e problemeve sociale që do të krijohen nga shkurtimet dhe zëvendësimet e punonjësve, si pasojë e kalimit nga aktiviteti konservues që ushtron sot "Albbakri" në objektet e përfshira në koncesion, në aktivitetet ndërtues dhe pjesërisht konservues që do të fillojë të ushtrojë Koncesionari.



Të marrë përsipër të mbajë të lira rrugëkalimet dhe hyrjet në objektet e koncesionit.

Të ndihmojë dhe të asistojë Koncesionarin për zgjidhjen e konflikteve nga pretendimet e padrejta të të tretëve ndaj tij, lidhur me problemet e mbrojtjes së mjedisit, apo edhe për pretendime të tjera të pa drejta nga të tretet për zhdëmtime të natyrave të ndryshme.

Të marrë në dorëzim nga Koncesionari objekte të veçanta të objektit të koncesionit, të cilët në përputhje me nenin 6, gërma 6.5, do të rezultojnë pa efektivitet ekonomik.

#### Neni 8

##### **Vlerësimi i investimit**

- 8.1 Investimi i përgjithshëm i Koncesionarit do të jetë me kushtet dhe sa është parashikuar nga Projekti, sipas specifikimeve të nenit 3, të paraqitura në Aneksin 2.
- 8.2 Ndryshime në Projekt të bëhen me pëlqimin e të dy palëve dhe vlera e uljes të mos jetë më shumë se 10% e vlerës së përgjithëshme të investimit të specifikuar në nenin 3 dhe paraqitur në Aneksin 2.
- 8.3 Nuk konsiderohen ulje investimesh, rastet, kur investimet për çdo objekt të parashikuar në programin e investimeve (Projekt), realizohen me fonde investimesh më të vogla, ose anasjelltas.

#### Neni 9

##### **Periudha e koncesionit**

- 9.1 Në bazë të kësaj Marrëveshje, OSHA-ja i beson Koncesionarit të shfrytëzojë në mënyrë efektive për 30 vjet objektet e përcaktuara në nenin 2 të Marrëveshjes.
- 9.2 Periudha prej 30 vjetësh fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, siç është parashikuar nga neni 20.
- 9.3 Periudha e përcaktuar në pikën 9.1 mund të ulet, kur zgjidhet Marrëveshja për njërin nga rastet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, ose të zgjatet, në rastin kur verifikohet një ngjarje e forcës madhore.

#### Neni 10

##### **Detyrim për koncesionarin**

Koncesionari detyrohet që me përfundimin e periudhës së koncesionit, t'i transferojë OSHA-së të reabilituar objektet e marra në koncesion.

#### Neni 11

##### **Mbështetja për Projektin**

Për afatin 5 vjeçar të periudhës së investimit, Shoqëria Koncesionare do të përjashtohet nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH-së, për makineritë, linjat e pajisjet që do të përdoren për investime, sipas specifikimeve në Projekt.

Shoqëria Koncesionare do të përjashtohet nga taksa e fitimit për pesë vite të plota ushtrimore, pas vitit të tretë, duke filluar llogaritja e viteve, 90 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me bilancin e paraqitur në Aneksin 3.

Përjashtimin e Shoqërisë Koncesionare nga taksat doganore dhe TVSH-ja, për makineritë, pajisjet dhe lëndën djegëse që do të përdorë për prodhimin e energjisë elektrike të nevojshme për objektet e koncesionit pas 5 viteve të para, në rast se Koncesionari do të kërkojë ta prodhojë vetë këtë energji elektrike.

## Neni 12

### **Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit**

OSHA-ja ka të drejtë të fillojë procedurën e prishjes së Marrëveshjes, për rastet kur konstaton shkelje të detyrimeve të marra përsipër nga Koncesionari.

Në qoftë se nga ana e OSHA-së konstatohen rastet e përmendura në paragrafin e parë, ato menjëherë do t'u bëhen të ditura palës tjetër dhe do të presë për një periudhë 30 ditore përgjigjen me shkrim të Koncesionarit me argumentet përkatëse. Mbi bazën e këtyre përgjigjeve, OSHA-ja do të vendosë për të filluar ose jo procedurën për zgjidhjen e Marrëveshjes.

Në qoftë se OSHA-ja do të vonohet në plotësimin e detyrimeve të saj, Koncesionari ka të drejtë të fillojë procedurën për zgjidhjen e Marrëveshjes sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë.

OSHA-ja ka të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanëshme nga Marrëveshja e Koncesionit, në rast se Koncesionari, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, pa shkak dhe jo për faj të mosrespektimit të detyrimeve të OSHA-së, nuk paraqitet për të realizuar detyrimet e tij kontraktuale.

## Neni 13

### **Paraqitja e bilanceve ekonomiko-financiar**

Bilancet ekonomiko-financiare do të mbahen dhe do të paraqiten pranë organeve shtetërore shqiptare për efekt detyrimesh fiskale, etj., në lekë për të gjithë aktivitetin ekonomiko-financiar të Koncesionarit në të tërë sektorët e Objektivit të Koncesionit të marra së bashku, e jo e ndarë për aktivitete ekonomiko-financiare të veçanta të sektorëve të ndryshëm të objektivit të koncesionit.

## Neni 14

### **Kontratat**

Koncesionari ka të drejtë që të përdorë nënkontraktorë për realizimin e Projektit.

Në të gjitha kontratat që do të lidhë Koncesionari me të tretët, ai duhet të respektojë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe nenet e kësaj Marrëveshjeje.

Koncesionari do të jetë përgjegjësi i vetëm kundrejt OSHA-së për zbatimin e përpiktë të Projektit, pavarësisht nga kontratat që do të lidhen me të tretët.

OSHA-ja nuk ka asnjë detyrim kundrejt të tretëve që lidhen me Koncesionarin dhe me këtë Marrëveshjeje.

## Neni 15

### **Sigurimet**

Koncesionari, për të gjithë periudhën e koncesionit dhe me shpenzimet e veta, do të sigurojë objektin e kësaj Marrëveshjeje, në institucionet përkatëse të sigurimit.

Koncesionari pajis OSHA-në me kopjet e dokumentacionit përkatës për sigurimet e bëra.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve për të cilat është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari për këtë qëllim, do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionuese në parametrat e Projektit.

## Neni 16

### **Riparimi dhe Mirëmbajtja**

Gjatë periudhës së Koncesionit, Koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjithë riparimet dhe mirëmbajtjet e nevojshme, të zakonshme e të jashtëzakonshme, të aseteve që do të merren në dorëzim nga ana e tij, në përputhje me gërmën "b" të nenit 7.

Neni 17  
**Kontrolli dhe inspektimet**

